

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE *e Raportit te VNM-se*



Objekti : “Prodhimi i inerteve dhe asfaltobetonit“

Vendndodhja : Fshati Sofracan , Komuna Zerqan , Rrethi Bulqize, Qarku DIBER



I.-Te Pergjitheshme .Qellimi i projektit

“SELAMI” sh.p.k. Diber i krijuar qene 1994 si nje ndermarje familjare me kapital te perbashket. “SELAMI” sh.p.k.,tashme eshte nje kompani e rendesishme dhe e specializuarndertimi qe mund te plotesoje te gjitha kerkesat e klienteve ne sektorin e ndertimit dhe rrugor. Ne mund te kenaqim klientet tane me punime te cilesise se larte dhe me nje çmim vertet konkurues. Shoqeria ofron sherbim te perhershëm pavaresisht motit, fale teknologjive e pajisjeve te standarteve europiane dhe njekohesisht jemi ne gjendje te ofrojme sherbimin tone ne çfaredo kohe dhe pavaresisht kushteve klimaterike. Pervec prodhimit te asfaltit te nxehte e te ftohte, ne ofrojme edhe prodhim stabilizantesh, inertesh dhe qe prej vitit 2004 dhe parafabrikate betoni te çdo lloji, te cilesise se larte,te standartit europian. Ne u shtrimin e ketij aktiviteti dhe permbushjen e kerkesave te ndryshme te ndertuesve,perfaqesuesi ligjor i ketij subjekti ka blere ne vitin 1997 nje sipërfaqe toke prej 9000 m², inproduktive dhe e pashfrytezuar me pare,ne fshatin Sofracan te komunes Zerqan, qe i perket rrethit Bulqize,ne te dy anet e rruges automobilistike Shupenze-Bulqize, rreth 500 m larg ures se fshatit Cereneç, e cila njekohesisht lidh keto fshatra me zonen e Gollobordes. Ne kete sipërfaqe toke,perfaqesuesi ligjor i ketij subjekti,ka montuar dy linja; te perpunimit te granilit e prodhimit te inerteve,si dhe nje impiant te prodhimit asfaltobetonit.

Vendosja e ketyre linjave te prodhimit te lendeve te ndertimit,ne kete sipërfaqe toke dhe ushtrimi i ketij aktiviteti,per vete edhe faktin e funksionimit normal qe prej vitit 2007, nuk perben ndonje problem shqetesues , te fqinjesise,popullates dhe mjedisin ne pergjithesi. Kjo sipërfaqe toke eshte e vecuar nga shtepite dhe banoret e kesaj zone,te cilet jane te perqendruar ne fshatrat me te afert, Sofracan,Sopot,Cereneç,te cilet ndodhen rreth 2-3km larg objekteve, per te cilat bejme fjale ne kete material.

Njekohesisht ,duhet te theksojme,se subjekti “Selami” ,ne kryerjen e ketij aktiviteti,perdor makineri e paisje bashkekohore dhe zbaton me korektesi te gjitha kushtet e kriteret e percaktuara ne lejen mjedisore,duke mos shkaktuar ne kete menyre ndonje problem shqetesues per banoret dhe ne pergjithesi per mjedisin ne kete zone.

Zhvillimi i ketij aktiviteti ka synim te plotesoje nevojate rendesishme te ndertimit perinerte,asfalte,betone te markave te ndryshme si dhe emulsione te ndryshme per shtrim rruges, ne varesi te kerkesave te porositesve.

Per realizimin e ketij aktiviteti jane realizuar investime qe afersisht kapin shifren e 970.000 Leke.

Ne ushtrimin e ketij aktiviteti,**subjekti “Selami” sh.p.k,eshte i paisur me leje mjedisore ,nga Ministria e Mjedisit,Pyjeve dhe Ujrave,qe ne vitin 2007, leje te cilen ai kerkon ta rinovoje,ne zbatim te dispozitave ligjore ne fuqi.**

Ne zbatimin e dispozitave ligjore per kufizimin ne shfrytezimin e rezervave te inerteve ne lumenj,per ushtrimin normal te ketij aktiviteti,subjekti “Selami”,siguron lenden e pare per



prodhimin e inerteve, ne nje siperfaqe toke shkembore, prej 6000 m², e cila ndodhet ne fshatin Sopot te komunes Zerqan te rrethit Bulqize e cila ndodhet rreth 2-3 km larg linjes se perpunimit dhe prodhimit te inerteve. Kjo siperfaqe toke eshte pjese e perbashket e fshatit Sopot, me te cilet eshte rene dakort ne shfrytezimin e saj, gje qe eshte plotesisht e vertetueshme, per vete faktin se qe nga viti 2007 i fillimit te punimeve e deri me sot ,perfaqesuesit e ketij subjekti nuk kane mosmareveshje e probleme te ndryshme shqetesuese ne ushrimin normal te ketij aktiviteti.

II -Vendndodhja e Objektivit

Sheshi i ndertimit te Impinatit te inerteve dhe Asfaltit ndodhet ne fshatin Sofracan te Komunes Zerqan. Ai shtrihet ne krahun e majte te rrjedhjes se lumit Bulqize, rreth 70 ml larg buzes se skarpates se lumit, ne te dy anet dhe buze rruges automobilistike Peshkopi-Bulqize-Tirane. Ne vetvete ky shesh perfaqeson nje shtrat lumi me perberje toke vegjetale, shtresa argjile dhe prurje te tjera zhavoresh te lumit (sipas studimit gjeologjik). Pjerresia e sheshit eshte e vogel duke filluar me drejtim nga Perendimi ne drejtim te shtratit te lumit. Ne pjesen perendimore dhe jugore te sheshit ka pjese te ngritura te terrenit qe sherbejne si mburoje dhe nuk ka zona te rreshqitshme qe mund te demtojne bazamentet e makinerive.

Sheshi i ndertimit te Fabrikes se Asfalto-Betoneve eshte nje siperfaqe prej 14 800 m².

Ai kufizohet :

- nga Veriu kufizohet me rrugen automobilistike nacionale ne distance rreth 10 ml ;
- nga Jugu lumi i Zallit te Bulqizes
- nga Lindja ndodhet direkt lumi rreth 70 ml larg ;
- nga Perendimi vjen direkt rruga automobilistike nacionale.

Paraprakisht qe ne kohen e fillimit te investimeve, jane kryer me pare investime te tilla si ndertimi i rrugeve hyrese e dalese nga te dy impiantet ne te dy anet e rruges nacionale, sistemimi i sheshit me zhavor te paster. Eshte arritur nje sistem drenazhimi dhe kullimi perfekt i ujrave te bardha. Gjithashtu nga studimi gjeologjik ka rezultuar se me vendosjen e makinerive te planifikuara, ky shesh nuk rreshqet.

Siperfaqja e tokes eshte inproduktive dhe eshte nuk eshte perdorur me pare. Ajo nuk ka ndonje status mbrojtjeje dhe nuk perben problem pronesia dhe pronesia. Ne afersi te kesaj siperfaqe toke nuk ka banesa dhe aktivitete te tjera ndaj te cilave mund te kishte ndonje ndikim ushtrimi i aktivitetit te lartepmendur.

Per prodhimin e inerteve ,investitori ,si lende te pare,shfrytezon disa rezerva shkembore algjirore ne fshatin Sopot te po kesaj komune duke shmangur marrjen e inerteve ne Zallin e Bulqizes dhe ate te Okshtunit,te cilat ndodhen shume prane kesaj siperfaqe toke dhe jane shume te pershtateshme per prodhimin e franksioneve te ndryshme te inerteve dhe asfaltobetonit.



Njekohesisht,duhet theksuar se impianti i prodhimit te asfaltobetonit eshte me nje teknologji shume te mire bashkekohore duke punar me gaz te lengshem GLP,gje qe ben qe sasia e gazeve qe dalin nga oxhaku i furres eshte i paperfillshem dhe pa ndikim negative ne ajer.

III- Arsyet e perzgjedhjes se vendit

Ne perzgjedhjen e kesaj siperfaqe toke ne ushtrimin e ketij aktiviteti dhe montimin e linjave te prodhimit te inerteve e te asfaltobetonit,investitori ka pasur parasysh disa faktore pozitive:

- *Siperfaqe e tokes ndodhet ne nje vend shume te pershtatshem per kryerjen e ketij aktiviteti,buze rruges automobilistike Peshkopi-Golloborde-Bulqize gje qe favorizon shume marrjen e lendes se pare dhe transportin e prodhimeve*
- *Toka ku jane vendosur e montuar linjat e prodhimit te inerteve e asfaltobetonit eshte inproduktive dhe e pashfrytezuar.Ajo nuk ka ndonje status te vecante mbrojtjeje dhe nuk ka probleme pronesia*
- *Nevojat per uje teknologjik plotesohen duke shfrytezuar ujrat e Zallit te Bulqizesdhe te Okshtunit qe jane shume prane siperfaqes se tokes.*
- *Energjia elektrike merret nga rrjeti shperndares i zones dhe ne raste te nderprejeve te saj plotesohet me gjenerator elektrik me motorr diezel.*
- *Nuk ka pasur nevojte shume per te kryer investime te medha ne ndertimin e rrugeve dytesore. Per te lidhur objektin e inerteve qe ndodhet ne breg te lumit me rrugen nacionale Peshkopi-Bulqize-Tirane jane ndertuar rreth 200 m rruge hyrese e dalese. Ndersa per te lidhur fabriken e asfaltit qe ndodhet mbi rrugen nacionale qe permendem me lart është ndertuar perseri nje segmenr i ri rruge 100 m.*
- *Hartimi dhe realizimi i ketij projekti ben te mundur përdorimin racional te mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve dhe te ndotjeve duke siguruar keshtu parandalimin e dëmtimit te mjedisit dhe duke bere rehabilitimin dhe shëndoshjen e tij me rritjen e hapësirës se gjelberuar , duke bere mbjelljen e pemeve fidanishte dhe dekorative te cilat do te ndihmojne ne pastrimin e ajrit mjedisor ne kete zone nga pluhurat dhe perberesit e tjere te ndotjes.*

Pershkrimi i hollesishem i projektit

II.a.- Karakteristikat e projektit :Pershkrimi i proceseve kryesore, teknologjia, kapaciteti, lendet e para, lendet ndihmese, produktet e ndermjetme dhe ato perfundimtare;

II.a.1.- Pershkrimi i pergjithshem.

“SELAMI” sh.p.k Diber eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar ne vitin 1994. Ajo ushtron veprimtarine e saj ne fushen e prodhimit te materialeve te ndertimit si rere, granile, asfalte si dhe ne ndertime rrugore dhe punime te tjera civile.

Linja e inerteve dhe ajo e asfaltit ndodhet ne fshatin Sofracan te Komunes Zerqan te rrethit te Bulqize. Konkretisht ajo ndodhet ne breg te lumit te vogel qe vjen nga zona e Bulqizes (Zalli i Bulqizes), ne fshatin Sofracan,ne te dy anet e rruges automobilistike Peshkopi-Bulqize-Tirane. Vlera totale e investimit eshte 570 000 Euro. Numri i punonjesve eshte 25.



Shoqeria ofron sherbim te perhershëm pavaresisht motit, fale teknologjive e pajisjeve te standarteve europiane, duke siguruar nje sherbimin ne çfaredo kohe dhe kushtesh klimaterike. Perveç prodhimit te asfaltit te nxehte e te ftohte, subjekti ofron edhe prodhim stabilizantesh, inertesh dhe qe prej vitit 2004 edhe parafabrikate betoni te çdo lloji, te cilesise se larte te standartit europian. Duke konsideruar qellimin e realizimit dhe funksionimit te ketij projekti per prodhimin e inerteve dhe asfaltobetonit ne plotesimin e kerkesave te subjekteve te ndryshme ne fushen e ndrtimit , ky objekt ndihmon ne bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror te kesaj zone dhe vendit tone ne teresi ne perputhje me kërkesat e zhvillimit te qëndrueshëm te shoqerise sone duke ndihmuar dhe duke qene pjese integrale per forcimin e rrjetit institucional te mbrojtjes se mjedisit ne nivel vendor dhe duke ndihmuar ne përmirësimin e kushteve mjedisore qe lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit te njeriut duke qene ne zbatim te saj qe :

“Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për te gjitha organet shtetërore, personat fizike dhe juridike, vendas e te huaj, qe ushtrjnë veprimtarinë e tyre ne territorin e Republikës se Shqipërisë “.

II-a.2. Menyra e organizimit te Linjes se Inerteve te Ndertimit dheAsfaltit

Linja e inerteve te ndertimit dhe ajo e asfaltit, e shoqerise “SELAMI” shpk Diber, eshte e perbere nga keto linja prodhimi ose (impliante prodhimi) :

A.- Impiant Fraksionimi Inertesh :

- siperfaqja800 m²,
- vlera e investimit 13000 000 Lek,

B.- Impianti i Asfaltit :

- siperfaqja 350m²,
- vlera e investimit22 800 000 Lek,

C.- Oficina Mekanike dhe Parku i Automjeteve:

- siperfaqja 100 m²,
- vlera e investimit 10 000 000 Lek

D.- Sheshet e depozitimit (ose magazinat) e lendes se pare inerte dhe te produkteve te ndryshme :

- siperfaqja150 m²,
- vlera e investimit4200 000 Lek

III.- Pershkrimi i parametrave kryesore te prodhimit



Pershkrimi i teknologjise se prodhimit.

III-A.- Impianti Thyerje-Fraksionimi-Larje Inertesh

Impianti i Fraksionimit te Inerteve eshte linja e pare teknologjike e investuar ne vitin 1994. Ai ze nje sipërfaqe 1 400 m² dhe per kete jane investuar 13 000 000 Lek.

Ky impiant u ngrit ne mbeshtetje te shfrytezimit te inerteve shkembore qe ndodhen rreth 3km larg objektit,ne afersi te fshatit Sopot te komunes Zerqan.Me rastin e kufizimit te shfrytezimit te inerteve lumore, ne zbatim te Ligjit Nr.8093, date 21.03.1996 "Per Rezervat Ujore" si dhe Vendimeve te K.M. Nr. 441, date 26.09.2002 dhe Nr.19, date 09.01.2003 ,shoqeria "SELAMI" sh.p.k.Dibër ,ne ushtrimin e ketij aktiviteti, **si lende te pare shfrytezon materialet inerte ne nje sipërfaqe shkembore te fshatit Sopot ,duke kufizuar ne kete menyre shfrytezimin dhe marrjen e inerteve ne shtreterit e lumenjve qe kalojne prane objektit.**

Lenda e pare (granili) qe merret ne kete sipërfaqe toke,e cila ndodhet rreth 3km larg objektit ku eshte instaluar linja e perpunimit dhe prodhimit te inerteve,perpunohet sipas kerkesave ne franksione te ndryshme. Per marrjen e lendes se pare dhe transportin e saj shoqeria ka ne dispozicion tre makina te tonazhit te rende,te cilat kryejne furnizimin e linjes se perpunimit te inerteve.

Linja e prodhimit te inerteve ,kryen perpunimin e granilit dhe prodhimin e franksioneve te ndryshme sipas kerkesave te ndertuesve dhe konkretisht:

- rere 0.5 mm,
- granil 1 me dimensione 5-10 mm,
- granil 2 me dimensione 10-20 mm.

Kapaciteti perpunues eshte afersisht 25 m³ ne ore. Makinerite jane të paraqitura sipas radhes funksionale të tyre :

+ Bunkeri i pranimit te lendes se pare 40 m³ qe vjen nga magazina ose direkt nga automjetet qe e sjellin nga furnitoret nga ku blihen inertet. Ajo mbushet me kamionavetshkarkues qe ngjiten nepermjet një "piacale" të vogel deri tek gryka e saj.

+ Nje pajisje ushqyese ne forme shneku (Karrel Mod. AC 60) me permasa te dritares furnizimit 560 x 2600 mm qe ndodhet e montuar në fund të bunkerit të furnizimit me lende të pare (Trimozha) per transportierin, vihet ne pune nga nje motorr elektrik 5.5 kw,

+ Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 60/24 me permasa te transportuesit 600 mm x 24 m dhe fuqi motorrike 7.5 kw. Lenda e pare nepermjet ketij transportieri kalon nga bunkeri i furnizimit franto.

+ Franto Granulimi Mod.GRC 100 sherben per te thyer kokrrizat e medha nga 20-170 mm te inerteve qe rikthehen nga sita nepermjet transportierit me shirit. Permasat e dritares se furnizimit jane 200 x 1000 mm, ka një fuqi motorrike 45 kw. Frantoja është e pajisur edhe me aksesore të tjere metalike të nevojshem,



+ Nje pajisje ushqyese me vibrim elektromekanik (Karrel Mod. AV 60) per frantone me permasa 600 x 600 mm qe vihet ne pune nga dy elektromotorre 0.7 + 0.7 kw,

+ Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 60/24 me permasa te transportuesit 600 mm x 24 m dhe fuqi motorrike 7.5 kw. Lenda inerte e thyer ne copa me te voglanepermjet ketij transportieri kalon nga frantoja ne lavatriçen rrotulluese ku behet larja me uje te rrjedhshem.

+ Sita Vibruese Mod. VV 1553 me larje me 3 tipe sitash koaksiale me permasa 1500 x 5000 mm për dimensione të ndryshme të lendes inerte, ka nje fuqi motorrike 11 kw,

+ Bunker i vogel me shnek qe mbledh fraksionin e 0-5 mm te reres dhe ushqen transportierin e ketij fraksioni, vihet ne pune me nje motorr elektrik me fuqi 2.2 kw,

+ Rera e imet 0.5 mm kalon nga bunkeri me shnek ne nje lavatriçe tjeter te veçante vetem per reren e cila ka kerkesa me te larta teknologjike sepse duhet te jete shume e paster per tu perdorur ne industrine e parafabrikateve te ndertimit.

+ Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 50/15 me permasa te transportuesit 500 mm x 15 m dhe fuqi motorrike 3 kw. Fraksioni 0.5 mm i reres nepermjet ketij transportieri kalon nga lavatriçja e reres dhe dergohet në sheshin e hapur të depozitimit të produktit të gatshem,

+ 2 Transportiera me rrip gome antiabraziv Mod.NT 40/15 me permasa te transportuesit 400 mm x 15 m dhe fuqi motorrike 2.2 x2 kw. Fraksionet 5-10 dhe 10-20 mm i reres nepermjet ketij transportieri kalon nga sita vibruese në sheshin e hapur të depozitimit të produktit të gatshem,

+ Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 50/13 me permasa te transportuesit 500 mm x 13 m dhe fuqi motorrike 4 kw. Fraksioni i trashë i inerteve mbi 20 mm nepermjet ketij transportieri rikthehet nga sita vibruese qe del si mbetje dhe dergohet në bunkerin e mullirit (silos) me synimin për ta bluar dhe rikthyer perseri në site,

+ Silos 6 m3 qe grumbullon materialin inert mbi 20 mm të rikthyer nga sita me synim për ta bluar ne mullirin me çekiça,

+ Mulliri me çekiç sherben per te thyer kokrrizat me te medha se 20mm te inerteve qe rikthehen nga sita nepermjet transportierit me shirit. Permasat e dritares se furnizimit jane 200 x 1000 mm, ka një fuqi motorrike 45 kw.

+ Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 50/13 me permasa te transportuesit 500 mm x 13 m dhe fuqi motorrike 3 kw. Materiali inert i thyer qe del nga mulliri nepermjet ketij transportieri kthehet perseri ne sistemin e prodhimit ne pozicionin per ta rikthyer perseri në site,

Lenda e pare, nga magazina e lendeve te para ose e blere, futet nga piacala ne bunkerin 1. me ane te transportierit 2 ajo kalon nje frantone 3 ku behet thyerja e copave te medha te gurit mbi 20 mm. Nga frantoja kalon me transportier ne lavatriçen horizontale rrotulluese 4 ne te cilen behet larja e baltës (dhera e argjila) me uje te rrjedhshem. Pastaj



nepermjet sitave rrotulluese koaksiale 5 behet ndarja ne fraksione e reres dhe e granileve. Fraksioni i trashe rikthehet perseri me nje transportier tjetër ne bunkerin 6 te mullirit me çekiça 7. Ne mullirin me çekiç behet bluarja e copave te inerteve (gureve) me te medha se 20 mm dhe me te vogel se materiali qe hyn ne franto. Nga mulliri me çekiç materiali i punuar kalon perseri ne sistemin e sitave per fraksionim. Rera e imet 0.5 mm kalon perseri per larje ne lavatriçen e reres. Larja e reres eshte kerkese teknologjike e materialeve inerte te cilesise se larte.

Gjate larje-fraksionimit te inerteve kemi nje prodhim mbetjesh, te cilat i ndajme ne :

- te ngurta. Ato perbejne afersisht 10-15 % te lendes pare ne qofte se do te perdoret rezerva e ardhur direkt nga lumi. Keto mbetje perbehen nga dhera dhe argjila qe dalin gjate procesit te larjes. Ato jane perdorur dhe perdoren për të mbushur gropat, për të sistemuar sheshin e prodhimit e terrenin me të afert dhe per te mbrojtur brigjet e lumit afer objektit.

- te lengeta jane ujrat teknologjike te larjes se inerteve te cilat derdhen ne lume duke infiltruar ne sheshin e shtruar me inerte. Keto ujra mblidhen ne fund te impiantit dhe nepermjet nje kanali dalin nga muri rrethues e prones dhe shkarkohen ne zallin Okshtunit qe ndodhet prane objektit.

- te gazta jane te paperfillshme dhe konsistojne ne gazrat e djegies se karburantit te fadromave ose automjeteve qe sjellin guret ose zhavorin etj. ne impiant. Ne rastet e mungeses se energjise perdoren edhe gjeneratorët elektrike me motorr diezel per te furnizuar impiantet me energji elektrike. Ndersa gjate punes nuk krijohen pluhra sepse materiali eshte i lagur. Ai hyn ne proces te prodhimit me 9-10 % lageshti dhe perseri laget gjate larjes para se te hyje ne franto.

III-B.1.- Impianti i Asfaltit

Impianti i pergatitjes dhe prodhimit te konglomerateve bituminoze perbehet nga makineri e mjete bashkekohore italiane te markes "BENARDINI", te cilat ne saj te funksionimit me gaz sigurojne zhvillimin e ketij aktiviteti, duke mos krijuar probleme per ndotjen e mjedisit per zonen ne afersi te objektit.

Prodhimi i ketyre produkteve bituminoze kryhet per nevojat e teknologjise se shtrimit te rrugeve automobilistike. Destinacioni i tyre do te jete per nevoja te tregut shqiptar te shtrimit te rrugeve.

Me percaktimin konglomerate bituminoze kuptohen te gjitha perzierjet e agregateve inerte(zhavor, rere, dhe mbushes) te perziere ne shumicen e rasteve ne te nxehte me bitum qe sherben si lidhes dhe qe jane te pershtatshem per te shtruar rruget, aeroportet, pistat e atletikes, veshje per kanale, fusha tenisi etj. Ato kane ngjyre te zeze(kur nuk perdoren ngjyrues), kane aroren tipike te bitumit dhe nje gjendje fizike viskoze. Temperatura e prodhimit është afersisht 150°C.

Menjehere pasi futen ne pune, me anen e pajisjeve perkatese, duke qene dhe nje mase kompakte ngurtesohen per shkak te ftohjes duke ruajtur tepaprekura karakteristikat e fleksibilitetit te lidhesit ne fjale. Perpjestimi i granulometrise te agregateve perberes te



misheles dhe bitumit, kryhet mbi bazen e specifikave te sakta qe mbajne cilesi te veçanta te fleksibilitetit dhe kompaktesise. Ne raste te veçanta eshte parashikuar gjithashtu, perdorimi i disa shtesave te tjera si gome, ngjyrues, avullues, materiale elastike, etj. me qellim qe t'i rrisin karakteristikat. Ne kete proces teresisht automatik fitohet cilesia me e mire dhe rendimenti maksimal ne prodhimin e konglomerateve permes ketyre fazave:

- Predozimi eshte faza e pare nga ku behet pergatitja e mases se sakte te fraksioneve te inerteve qe do te futen ne procesin e prodhimit. Ato ndodhen ne bunkere te veçante dhe me transportier kalojne ne cilindrin e ngrohje-tharjes. Per çdo fraksion te inerteve dozimi behet me drejtim e komandim ne distance.

- Tharja dhe Ngrohja. Inertet dergohen normalisht me nje rrip transporti, ne nje furre cilindrike rrotulluese sigurisht te izoluar dhe te pajisur ne anen e kundert, me nje brucator (ndezez automatik)gazi me rregullim te flakes dhe te nje kanali shkarkimi ne te cilin eshte vendosur nje sistem termoçiftesh ose nje sistemi optik me rreze infra te kuqe per rregullimin e temperatures te zhavorit rrjedhes. Flaka, ne brendesi te tamburit, eshte e lire por ajo kurre nuk bie ne kontakt me materialin qe trajtohet. Kyi fundit me qe furra eshte e pjerret avancon drejt pjeses me te nxehte i ndihmuar per te levizur edhe nga disa paleta te vendosura ne gjatesi te mureve te brendshme te cilindrit. Kembimi i nxehtesise ndodh si shkak i percjellshmerise-konveksionit dhe rrezatimit. Dhekonsumi i gazit megjithese ndryshon nga lloji i agregatit, varet mbi te gjitha nga sasia e lageshtise qe eshte rreth 5-7 kg/ton te materialit. Temperatura e tymrave ne dalje te fures rezulton me e vogel se sa ajo e agregatit duke qene ne kufijte 120 – 150°C.

- Riklasifikimi dhe perzierja ne te ngrohite e nje perberje te moderuar e perzierjes granulometrike(se cilesi i perkasin zhavori i madhesive te ndryshme, rere, mbushesi perkates si dhe mbushesi shtese), dozimi i bitumit dhe shtesave te tjera, perzierjes dhe ne fund grumbullimi i prodhimit te perfunduar.

Nga cilindri pjeset e ngrohura kalojne me elevator ne peshuesin automatik ku behet aktualisht edhe nje riklasifikim te inerteve. Gjithashtu nga cilindri dalin edhe tymrat te cilat sipas llojit te procesit transportojne ne fluksin e tyre drejt levizjes pjeset me te lehta si mbushes dhe rera te imta duke e varferuar ne kete menyre konglomeratin i cili ka nevojë per keto pjese(nuk eshte i rralle rasti kur duhet qe t'i shtojme mbushesa me origjine nga procese te tjere industriale, si p.sh. nga furrenaltat, n.q.s. perzierja origjinale eshte e varfer). Nga ketu del se perveç konsideratave te tipit ekologjik lind nevoja e perdorimit dhe rekuperimit te pjeseve te imta te lumit. Pra pjeset e imta, ne masen sipas recetes perkatese, rikthehen ne procesin e prodhimit duke siguruar nje element te duhur te asfaltit.

Ndermjet te gjithe tipeve te ndryshme te depolverizuesve ai qe ka rendimentin me te larte dhe me ekonomik eshte lidhesi. Rolin e lidhesit ne kete rast e kryen me se miri bitumi. Ne krahuin tjetër, ne linje te veçante vjen bitumi me temperature te barabarte(140-160°C) ose te perafert me materialet inerte te ngrohura ne cilindër. Bitumi i cili dozohet me pare, inertet dhe materialet e tjera shtese kalojne ne perzieres. Ne perzieres behet pergatitja perfundimtare e produktit te gatshem. Prodhimi i gatshem kalon me pas ne dy silosa te veçanta te vendosur ne te dy krahet e impiantit. Nga aty, ai eshte i gatshem per tu transportuar ne destinacionin e perdorimit



Perbri atyre qe u permenden me siper, qe jane fazat perkatese te prodhimit, ka edhe dy procedura shtese qe jane :

- Filtrimi i tymrave qe dalin nga furra si dhe ajo e tharje-ngrohjes se agregateve. Duhet theksuar se impianti i prodhimit te asfaltobetonit eshte me nje teknologji shume te mire bashkekohore duke punar me gaz GLP ,gje qe ben qe sasia e gazeve qe dalin nga oxhaku i furrës eshte i paperfillshem dhe pa ndikim negative ne ajer. Filtri i tymrave eshte nje pajisje e rendesishme qofte per procesin teknologjik ashtu edhe per mbrojtjen e ambientit nga ndotja. Kjo eshte nje pajisje qe ka kushtuar shume dhe qe kompletion kete lloji teknologjie. Pajisja me filter per shkarkimet ne ajer eshte aplikimi i nivelit dhe kerkesave te standarteve europiane qe po perdoret ne Shqiperi per kete lloj teknologjie. Niveli i shkarkimeve te pluhrave (inerte) dhe blozes eshte sipas standarteve te Bashkimit Europian. Per me teper, kjo sasi e mbetjeve te ngurta qe kapen nga filtri rifuten perseri ne menyre automatike ne procesin e prodhimit per te mos varferuar receten. Me kete duam te tregojme se filtrimi i pluhrave te imet është nje nevoje teknologjike separi per te mos ndryshuar raportet e perberesve te asfaltit. Ky eshte nje standart i impiantit asfaltit BENARDINI i cili ploteson ne menyre te kenaqshme edhe kerkesat e mbrojtjes mjedisit per kete lloj teknologjie.

- Ngrohja e agregateve te punes, e bitumit ne çisterna dhe tubacionet e transportit behet me transmetim nxehtesie me serpentina vaji. Nje kaldaje e veçante gazi ngroh depozitat e bitumit. Bitumi me 140-180 °C vjen me autoçisterne nga Fieri(bitum nafte). Gjithashtu kjo kaldaje ngroh te gjithë agregatet e tjere duke perfshire edhe furren cilindrike te tharje-ngrohjes se lendes pare inerte.

Siç u tha edhe me lart, te gjitha fazat e prodhimit, jane teresisht automatike. Nje kujdes i veçante i eshte kushtuar gjate projektimit aparateve qe sherbejne per predozimin e lendes pare, lendes djegese, kembimit termik ne furre, thithjes se tymrave dhe trajtimit te tyre duke patur parasysh koston e larte te lendes djegese, te agregateve dhe te problemeve ekologjike te lidhura me ambientin ku eshte vendosur ky kantier.

Vlerat fizike te lidhura me secilen nga fazat e lartpermendura dhe qe jane:

- prurja e çdo predozatori ne veçanti,*
- temperatura e produktit te perfunduar(sipas normes 140-160°C),*
- njesia e renies se presionit ne zonen ku ndodh djegja(sipas normes $-1 \div -2\text{mm H}_2\text{O}$), jane te vendosura ne instrumentet matese perkatese ne kabine dhe me anen e te cilave mund te behet e mundur mbajtja konstante e ketyre parametrave. Disa sisteme perkates alarmi nderhyjne per te modifikuar apo per te ndaluar n.q.s. eshte e nevojshme impiantin ateher kur vlerat qe tregojne aparatet largohen nga vlerat e lejuara se bashku me tolerancat perkatese.*

Pjese e impiantit jane edhe serbatoret e bitumit. Bitumi, ne temperaturën e mjedisit eshte shume viskoz dhe pak i rrjedhshem, keshtu qe duhet te arrije nje temperature te caktuar, rreth 180 °C, qe te rrjedhe normalisht. Nxehta e bitumit kryhet prej kaldajes. Kaldaja nepermjet djegies se gazit GLP nxeht vajin qe eshte trup pune per shkembimin e nxehtesise, i



cili duke qarkulluar neper tubacionet qe shtrihen brenda ne serbatoret e bitumit kryen transmetimin e nxehtesise nga kaldaja tek bitumi.

Gjithashtu serbatoret jane te lidhur midis tyre me nje sistem tjetër hidraulik. Ky sistem perbehet prej pompes dhe prej tubacionit dhe kryen qarkullimin e bitumit midis tre serbatoreve si dhe ndihmon nxehtjen e njetrajtshme te tij. Gjithashtu ky sistem kryen edhe furnizimin e serbatorit te rezerves prej autoçisternave te transportit.

Serbatori tjetër permban lenden djegese, gaz GLP. Prej ketij serbatori, kjo lende djegese shkon ne dy drejtime ashtu siç eshte permendur edhe me lart. Njeri furnizon kaldajen dhe tjetri furnizon i cilindrin e tharjes me gaz GLP per ngrohjen e materialit inert.

- Shkarkimet dhe mbetjet qe prodhohen

Shkarkimet ne ambient i klasifikojme sipas natyres se tyre :

V.a.- Shkarkimet ne ajer jane :

+ gaze te djegies se karburantit qe i referohen normes konsumit 400 -500 litra gaz GLP ne ore kur punon impianti i asfaltit. Koha e punes eshte komplet i papercaktuar per arsye te tregut te punes,

+ nga impianti i thyerjes-fraksionimit dalin 0,02 % pluhura me diameter me te madh se 0-10 mm dhe nje sasi shume e vogel pluhura me te imta.

V.b.- Shkarkimet e lengeta :

+ ujra te larjes se inerteve ne impiantin e larje fraksionimit te cilat rezultojne me balte (dhera dhe argjila rreth 30 % e lendes pare kur jane inerte lumore). Keto ujra filtrohen ne pirgjet e e zhavorit ne pjesen epjerret te impiantit larjes duke krijuar nje grumbullim balte gjate kohes se punes.

+ ujrata e tualetit te zyres me ane te nje tubacioni te vecante kalojne ne lume.

+ vajrat e paperdorshme qe mund te rezultojne ne ofiqinen e fabrikes afersisht mund te llogariten disa litra ne muaj. Ato depozitohen ne nje fuçi metalike per riperdorim per qellime te tjera.

V.c.- Shkarkimet engurta :

+ dherat e larjes se inerteve lumore te cilat grumbullohen ne afersi te larje-fraksionimit. Me pas keto dhera largohen dhe perdoren per mbushje dhe sistemim terreni. Ujrat e qarta me pas derdhen ne lumin e Bulqizes.

+ Mbetjet e tjera te perdorimit te perditshem nga aktiviteti i punonjesve te cilat zene nje volum relativisht te vogel te gjithë mbetjeve te ngurta. Keto pasi mblidhen dergohen ne vendshkarkimin e caktuar te mbeturinave prej komunes.

Zhurmat (ose ndotja akustike) :

+ Zhurma maksimale e agregateve te vecante te impiantit



perfshihet mes 125 dhe 400 Hz. Kundra efektit te zhurmave,ne distanca te shkurtera jane marre masa te tilla qe operatoret jane vene ne kushte te kondicionimit akustik dhe termik.

Ndersa per shmangien e zhurmave ne distanca me te largeta jane marre masat qe ne fillim te zgjedhjes vendit te ndertimit larg qendres se banuar dhe ne pozicion te maskuar te terrenit.

Gjithashtu per rreth impiantit jane vendosur grumbuj te medhenj zhavorri te cilet mbulojne komplet silueten e objektit.

Si rezultat i ketyre kushteve zhurma maksimale kundrejt pjeses me te madhe te punonjesve dhe zyrave nuk i kalon 75 dB, ndersa ky efekt per kalimtarët dhe banoret me te afert eshte shume me i zbutur.

V.e.- Efekti termik

+ Efekti termik eshte i pranishem tek impianti i asfaltit. Operatori qe komandon prodhimin ndodhet ne kabinen e tij te komandimit, e cila eshte nje konstruksion me kushte termoizolimi dhe mund te punohet normalisht. Kundrejt efekt termik mund te ekspozohen ne menyre te parrezikshme per pak minuta shoferet e transportit te asfaltit. Asnje punonjes tjetër apo banor nuk preket nga ky ndikim.

Planet ekzistuese te perdorimit te teritorit ku zhvillohet projekti.

Ne zonen e Linjes Inerte dhe Asfaltit "SELAMI", ne fshatin Sofracan te rrethit Bulqize,nuk ka asnje impiant tjetër fraksionimi inertesh qe shfrytëzon me leje ose ne menyre klandestine inertet lumore ose ato qe ndodhen ne kete zone. Ne lidhje me kete duhet theksuar se inertet qe ndodhen ne kete rajon nuk jane shfrytëzuar deri tani,edhe per faktin e mungeses se theksuar te investimeve dhe ndertimeve ne kete rajon. Afer saj, ne anen lindore dhe jugore, ndodhen parcela bujqesore te fshatareve Sofracan ,Sopot,Cerenec etj.

Studimi urbanistik i zones ne te cilen zhvillon veprimtarine ky subjekt ne Komunen e Zerqan , ne zonen e fshatit Sofracan, eshte mbeshetur ne keto parime baze te mbrojtjes se mjedisit :

a) parimin e zhvillimit te qëndrueshëm duke lejuar zhvillimin e kesaj veprimtarie ne perputhje me aktivitetet e tjera te kesaj zone ne menyre qe te funksionojë si aktivitet me qëndrueshmeri dhe ne rritje nepermjet funksionimit te rregullt , montimit te pajisjeve te duhura ndihmese te reja dhe ne gjendje te mire teknike , zbatimit me rigorozitet te kerkesave teknologjike per kete veprimtari .

b) parimin e kujdesit për te pakësuar rrezikun mjedisor, për te parandaluar dhe pakësuar ne kohen e duhur çdo dëmtim te ardhshëm te mjedisit . Ne funksion te kesaj ideje nga investitori eshte konceptuar te tregohet nje kujdes i vecante me qellim qe :

- 1. Te kemi ndotje minimale te mjedisit nepermjet masave te marra per kujdesin dhe mosndodhjen e avarive gjate funksionimit .*
- 2. Te mosndotet apo demtohet rruga nacionale Peshkopi-Bulqize-Tirane, nga levizja e mjeteve gjate hyrje e daljeve nga kjo pike prodhimi dhe tregtimi inertesh e asfaltobetoni.*



3. Te mos kemi ndotje akustike nga zhurmat e makinerive punuese apo gjate punes.

c) **parimin e parandalimit duke miratuar variantin me te mire**, qe ne fazën e fillimit te vendimmarrjes, për te shmangur ndikime te dëmshme te një veprimtarie ne mjedis. Per kete qellim eshte zgjedhur kjo prone dhe kjo veprimtari ne nje toke e cila nuk shfrytezohe per bujqesi apo aktivitete te tjera dhe ka shume vite qe nuk ka funksionuar per asnje aktivitet . Duke shfrytezuar faktin qe siperfaqja e tokes ku ushtrohet ky aktivitet eshte afer rruges kryesore qe lidh Shupenzen me Bulqizen dhe me pjesen tjeter jugore e perndimore te vendit tone , me nje kalueshmeri te madhe mjetesh dhe njerezish, investitori , pas konsultimeve te gjera ka vendosur te ndertoje kete pike perpunimi e prodhimi inertesh dhe asfaltobetoni duke konsideruar dhe faktin qe ky proces eshte i nevojshem per shkak te shtimit ne vijimesi te projekteve e investimeve dhe nuk sjell ndotje mbi ato te lejuarat ne mjedis .

ç) **parimi "ndotësi paguan"** qe nënkupton koston qe paguan ndotësi për përmirësi min e një mjedisi te ndotur dhe për kthimin e tij ne një gjendje te pranueshme , d.m.th pagesen e taksave vendore per pastrimin e ambientit . Investitori eshte i njohur me kete ligjshmeri dhe i zbaton ne vijim me rigorozitet detyrimet per kete sherbim pasi gjate kohes se shfrytezimit krijohen mbetje te ngurta , te lengeta dhe konsumatore te cilat depozitohen ne vendin e caktuar me pare nga pushteti vendor, ne piken e depozitimit te tyre te cilat me pas trajtohen terhiqen nga sherbimet e firmave te licensuara dhe te kontraktuara nga njesia vendore njelloj si aktivitetet e tjera te kesaj zone .Te gjitha mbetjet ndahen dhe trajtohen sipas udhezimeve dhe ligjeve ne fuqi vendore dhe qendrore si dhe udhezimeve perkatese te leshuara nga Agjensia rajonale e mjedisit .

d) **parimi i riparimit te dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit te mjedisit te dëmtuar nepermjet:**

1. Mbjelljes se pemeve karakteristike te zones te cilat jane te para shikuar ne studim urbanistik pjesor te kesaj zone.
2. Mbajtjen paster te sheshit te jashtem gjate shfrytezimit duke evituar hedhjen e mbeturinave te cfaredo llojshme ne te .
3. Pastrimin dhe trajtimin e ujrave te larjes perpara shkarkimit te tyre ne kolektorin kryesor te ujrave te bardha te kesaj zone .

dh) **parimi i përgjegjësisë ligjore** duke siguruar dokumentacion te plote ne zbatim te ligjshmerise gjate te gjithe kohes se funksionimit te ketij objekti . Persa i perket problemeve mjedisore , investitori eshte bere i njohur qe gjate periudhes se shfrytezimit te objektit duhet te beje raportimet tremujore te perberesve ndotes qe shkakton kjo veprimtari dhe ai do te mbaje rregjistra te rregullta per trajtimin e te gjithe mbetjeve .

e) **parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte** gjate ushtrimit te ketij aktiviteti duke u kujdesur gjate te gjithe fazave per mosndotjen e ambientit . Keshtu ne vijim te kesaj ideje ky aktivitet ka nje siperfaqe te mjaftueshme per kete veprimtari , jane sistemuar per momentin me shtresa materialesh inerte me origjine malore rruget dhe sheshet kryesore te sherbimit dhe duhet te mirembahen periodikisht ne menyre qe te mos krijohen pluhura. Ndersa sheshi ne te cilen jane montuar makinerite e prodhimit dhe vendngarkimi i automjeteve te transportit eshte i shtruar me beton dhe mbahet shume paster . Jane instaluar per kete



aktivitet dhe po perdoren pajisje te reja , te cilat punojne qete dhe pa rrjedhje , jane te kontrolluara dhe te sigurta ne zbatim te projektit

e) **parimi i integritimit te mbrojtjes se mjedisit** ne politikat sektoriale duke zbatuar ligjet dhe udhezimet ne fuqi si edhe urdheresat e ndryshme qe mund te dalin te Agjensise Rajonale te Mjedisit dhe te pushtetit vendor.

f) **parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes se publikut** afer kesaj zone ne vendim marrjen mjedisore duke u konsultuar me bizneset afer tij por edhe me pushtetin vendor . Ky objekt eshte ndertuar vite me pare nga investitori ne nje zone jashte qendrave te banuar dhe godinat e banesave private apo publike jane ne nje distance qe nuk ndikohen nga zhvillimi i ketij projekti dhe aktiviteti . Prandaj nga takimi dhe bisedat me keto banore ne afersi dhe perreth kesaj pike prodhimi inertesh e asfaltobetoni nuk ka ndonje problem shqetesues.

Masat per zbutjen e ndikimeve ne mjedis

Gjate instalimit te impianteve te prodhimit te inerteve te fraksionuara dhe te konglomeratit bituminoz, eshte e pasur parasysh ndikimi ndaj ambjentit ne nivelin ekologjik te pergjithshem. Domethene,jane marre ne konsiderate efektet qe i dedikohen te gjithe faktoreve te mundshem te ndotjes. Per te mbajtur nen kontroll te vazhdueshem keto impiante zbatohen me korektesi normat e mirembajtjes se agregateve te veçante sidomos i filtrit te ajrit, mbajtja nen kontroll e te gjitha llojeve te ndikimeve mjedisore, etj.

Impianti i thyerje-larje-fraksionimit eshte projektuar te punoje ne kushte te lageshta e cila garanton minimumin e emetimit te pluhrave ne ajer. Gjithashtu, ujrat e larjes perpara se te derdhen ne lume, filtrohen ne nje pengese rere e zhavori e cila mban dherat e argjilen. Ujrat dalin relativisht te pastra.

Ne impiantin e asfaltit nje kujdes i veçante i eshte kushtuar gjate projektimit aparateve qe sherbejne per predozimin e lendes pare, lendes djegese, kembimit termik ne furre, thithjes se tymrave dhe trajtimit te tyre duke patur parasysh koston e larte te lendes djegese, te agregateve dhe te problemeve ekologjike te lidhura me ambjentin ku eshte vendosur ky kantier.

Vlerat fizike te lidhura me secilen nga fazat e lartpermendura dhe qe jane :

- prurja e çdo predozatori ne veçanti,
- temperatura e produktit te perfunduar (sipas normes 140-160 °C),
- njesia e renies se presionit ne zonen ku ndodh djegja (sipas normes -1 ÷ -2 mm H₂O)

jane te vendosura ne instrumentet matese perkatese ne kabine dhe me anen e te cilave mund te behet e mundur mbajtja konstante e ketyre parametrave. Disa sisteme perkatese alarmi nderhyjne per te modifikuar apo per te ndaluar n.q.s. eshte e nevojshme impiantin atehere kur vlerat qe tregojne aparatet largohen nga vlerat e lejuara se bashku me tolerancat perkatese.



Impianti i asfaltit siç pershkruam me lart, eshte i pajisur me filter ajri per fraksionet e imta te blozes dhe puhurave te imta. Ai eshte projektuar ne menyre te tille qe nuk parashikon asnje sistem pune qe parashikon nxjerrjen e ketij filtri nga puna.

Mbrojtja ndaj zhurmave eshte zgjidhur ne maksimumin e mundshem nga prodhuesi i teknologjise. Per sa i perket efekteve te zhurmave ne distance te shkurter eshte e nevojshme qe te merret ne konsiderate qe ne nje kantier pune personat qe rendohen jane te pakte dhe normalisht ato jane :

- Operatori i drejtimit te impiantit qe gjendet ne kabinen e prodhimit S.I.M. eshte termikisht e kondicionuar dhe e izoluar nga zhurmat me anen e materialeve zhurme absorbues.*
- Shoferet e autokamionave, te cilet ne menyre periodike marrin produktin e perfunduar gjenden ne te njejtat kondita si personat e mesiperm.*
- Punonjesit qe merren me mirembajtjen e impiantit, te cilet nuk duhet te operojne kur makinat jane ne levizje dhe nepunesit e zyres qe normalisht jane te vendosur larg nga ku punon impianti.*

Per sa i perket efekteve te zhurmave jashte kantierit eshte e nevojshme te merren ne konsiderate qe shpesh kantijeret vendosen ne zona natyrore te mbrojtura ose ne gropa artificiale nen nivelin zero te terrenit, por edhe sikur ato te ishin te vendosura ne ambient te hapur, mund te pershtatet nje ambient analog duke perdorur grumbuj inertesh ne menyre qe te krijohen barriera kunder zhurmave ashtu siç eshte aktualisht ne impiatin tone ne shqyrtim.

Per mbrojtjen ne pune punonjesit jane te pajisur me mjete mbrojtese si doreza, syze, rroba pune, etj.

Ne rast te ndonje demtimi te mundshem te fabrikes, te pjeses fundore te terrenit nga ana e lumit nga erozioni, do te merren masa mbrojtese kundrejt shembjeve te tokes.

Perputhja e projektit me planet e rregullimit te teritorit dhe me planet e zhvillimit ekonomik te zones ku do te zbatohet projekti

Zhvillimi i ketij projekti eshte ne perputhje te plote me nevojat ekonomike te zhvillimit te vendit ne pergjithesi dhe, ne plotesim ne nivel te larte te kerkesave teknike per shtrimin e akseve te rendesishme rrugore te zones veri-lindore ne Shqiperi. Te gjitha hapat e investimeve jane kryer ne perputhje te plote me studimet e urbanistike qe jane kryer per kete qellim.

Organet e pushtetit vendor kane shprehur miratimin e tyre per zhvillimin e ketij projekti. Shqyrtimi i projektit nga zyrat e specializuara eshte konsideruar pozitiv per shume arsye. Miratimet e tyre jane shprehur ne lejet dhe deklarimet e veçanta zyrtare perkatese. Gjithashtu, duhet te theksojme se nuk ka asnje ankese publike apo deklarime kunder projektit te investimit nga banoret e zones dhe etj.

Nga te gjitha problemet e paraqituara ne Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis mund te nxirren disa perfundime. Projekti i propozuar i Linjes Inerteve dhe Asfaltit, nuk ka ndikime negative te dukshme ne mjedis per keto arsye :



- aktiviteti i propozuar nuk krijon probleme te ndotjes se ujrave ne zonen e afert me fabriken.
- aktiviteti i propozuar nuk demton habitate dhe nuk prish ekuilibrat biologjike natyrore,
- prodhimi i mbetjeve të ngurta është i vogel, megjithate ai mbahet nen kontroll dhe trajtimi i tyre behet konform detyrimeve ligjoretë subjektit,
 - çlirimi i gazeve mbahet nen kontroll të rrepte teknik,
- aktiviteti nuk ka ndikim negativ per popullaten,
- aktiviteti nuk zhvillohet ne “zone te mbrojtur” natyrore,
- aktiviteti ndikon ne zhvillimin ekonomik dhe ndihmon ne zgjidhjen e problemeve sociale te popullsise.

Nisur nga sa u paraqit me lart dhe ne dokumentacionin perkates shoqerues, perfundimisht mund te themi se aktiviteti i shoqerise “SELAMI” sh.p.k. Diber ne fshatin Sofracan te Komunes se Zerqan te rrethit te Bulqize, nuk krijon pasoja negative qe do ta pengonin aktivizimin e ketij aktiviteti. Mendojme se ky projekt i ploteson kerkesat mjedisore per te vazhduar normalisht aktivitetin dhe per te rinovuar Lejen ekzistuese te Mjedisit.

Linja e Inerteve dhe Asfaltit i shoqerise “SELAMI” sh.p.k. Diber, si aktivitet i vleresuar per tu pajisur me leje mjedisi, duhet te plotesoje keto kerkesa :

- te respektoje rregullat e sigurimit teknik ne pune per te mbrojtur shendetin e punonjesve,
- te respektoje normat teknologjike per prodhimin e produkteve te industrise se ndertimit (asfaltobetonet),
 - te ndjeke rregullisht largimin per ne destinacionin e duhur te mbetjeve te ngurta e te lengta dhe te mbaje nen kontroll administrimin e tyre sipas procedurave ligjore per shkarkimet industriale,
- te dergoje nje here ne tre muaj te dhenat e monitorimit sipas Vendimit te K.M. Nr.103, date 31.03.2002 “**Per monitorimin e Mjedisit ne Republiken e Shqiperise**”ne Agjensine Rajonale te Mjedisit Diber ne plotesim te detyrimeve ligjore per informacionin periodik mjedisor.

Masat rehabilituese ne rast ndotje dhe demtimi te mjedisit si dhe koston e tyre

Momentet ne te cilat mund te demtohet ambjenti i punes dhe me tej mjedisi natyror si rezultat i zhvillimit te aktivitetit ne shqyrtim jane :

- demtimi i mundshem i sistemit te filtrimit ne pune e siper,



- aksidentet e mundshme ne impiantin e emulsionit dhe depozitat e lendeve djegese te gazit GLP dhe gazoilit,
- hedhja e pakontrolluar e mbetjeve te ngurta e te lengta ne ambient,
- demtimi i truallit te ndertimit ne pjesen fundore te tij ne afersi te lumit nga veprimi errodues i ujrave te lumit,

Masat mbrojtese qe duhet te ndermerren jane keto :

- + te kryhen punimet restauruese ne pjeset e demtuara te pajisjeve te sistemit te filtrimit,
- + te organizohet me pergjegjesi largimi i mbetjeve te ngurta e te lengta ne destinacionin e duhur dhe te deklaruar,
- + te mbahen ne kontroll te posaçem e te vazhdueshem funksionimi i impiantit te emulsionit, kaldajes, etj.
- + te merren masa mbrojtese per te penguar avancimin e shtratit te ujrave te lumit ne drejtim te sheshit te depozitimit te lendeve te perpunuara inerte.

Ne planin e masave dhe organizimin e punes si per shfrytezimin e ketij objekti ashtu dhe per funksionimin e tij , investitori duhet te veproje ne menyre te tille qe minimizojë ndikimet negative ne mjedis , te parandalojë shkarkimet mbi norme dhe ndotjen e mjedisit dhe konkretisht :

.Sigurimi teknik,shoqeror dhe shendetesor i punonjesve .:

Per mbarevajtjen e funksionimit normal te ketij aktiviteti ne menyre qe puna te ece ne perputhje me legjistacionin ne fuqi dhe ne sherbim bashkekohor , si e vetmja menyre egzistente , del e domosdoshme sigurimi teknik i punonjesve dhe specialisteve sipas rregulloreve ne fuqi si dhe sigurimi shendetesor dhe shoqeror i tyre. Pa realizimin e ketyre detyrave funksionimi i objektit nuk mund te kuptohet. Per kete arsye rekomandojme qe instruktimi teknik te behet sipas rregulloreve ne fuqi .

Permbledhja Joteknike e kesaj veprimtarie u hartua nga : "ERALD - G" shpk

Ekspert i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Vendim Nr.13 , nr.111 Rregj.dt.23.11.2004

ing.Kujtim Canameti

Ekspert i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Vendim Nr.3 , nr.194 Rregj.dt.20.04.2006

ing.Arben MUHA

